# Manuali i përdorimit

## Kondicionieri Daikin për dhomë



FTXJ20A2V1BW
FTXJ25A2V1BW
FTXJ35A2V1BW
FTXJ42A2V1BW
FTXJ50A2V1BW

FTXJ20A2V1BS
FTXJ25A2V1BS
FTXJ35A2V1BS
FTXJ42A2V1BS
FTXJ50A2V1BS

FTXJ20A2V1BB
FTXJ25A2V1BB
FTXJ35A2V1BB
FTXJ42A2V1BB
FTXJ50A2V1BB

Manuali i përdorimit
Kondicionieri Daikin për dhomë

**Shqip**

# Tabela e përmbajtjes


1 Rreth dokumentacionit 2
1.1 Rreth këtij dokumenti 2
2 Udhëzimet e sigurisë për përdoruesin 2
2.1 Udhëzimet për përdorim të sigurt 2
3 Rreth sistemit 4
3.1 Njësia e brendshme 4
3.1.1 Llamba e treguesit të syrit Daikin 4
3.2 Rreth ndërfaqes së përdoruesit 5
3.2.1 Përbërësit: Telekomanda uajrles 5
3.2.2 Operimi i telekomandës uajrles 5
4 Para përdorimit 6
4.1 Vendosja e baterive 6
4.2 Montimi i mbajtëses magnetike të telekomandës uajrles 6
4.3 Ndezja e furnizimit me energji 6
4.4 Cilësimi i njësisë së brendshme 6
4.4.1 Hapni panelin e përparmë 6
4.4.2 Lidhje uajrles LAN 7
4.4.3 Funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit 9
5 Përdorimi 9
5.1 Gama e operimit 9
5.2 Gjendja e operimit dhe vlera e dëshiruar e temperaturës 9
5.2.1 Fillimi/ndalja e modalitetit të operimit dhe caktimi i temperaturës 10
5.3 Shkalla e qarkullimit të ajrit 10
5.3.1 Rregullimi i shkallës së qarkullimit të ajrit 10
5.4 Drejtimi i qarkullimit të ajrit 10
5.4.1 Rregullimi i drejtimit të qarkullimit vertikal të ajrit 11
5.4.2 Rregullimi i drejtimit të qarkullimit horizontal të ajrit 12
5.4.3 Për të përdorur drejtimin 3D të qarkullimit të ajrit 12
5.4.4 Fillimi/ndalimi i operimit të qarkullimit të ajrit në gjendje qetësie 12
5.5 Përdorimi i syrit inteligjent 12
5.5.1 Fillimi/ndalimi i operimit të syrit inteligjent 12
5.6 Operimi i fuqishëm 12
5.6.1 Fillimi/ndalimi i operimit të fuqishëm 13
5.7 Operimi ekono 13
5.7.1 Fillimi/ndalimi i operimit ekono 13
5.8 Operimi në qetësi i njësisë së jashtme 13
5.8.1 Fillimi/ndalimi i operimit në qetësi të njësisë së jashtme 13
5.9 Operimi i Flash Streamer (pastrimi i ajrit) 13
5.9.1 Nisja/ndalimi i operimit të Flash Streamer (pastrimi i ajrit) 14
5.10 Cilësimi i orës dhe kohëmatësit 14
5.10.1 Caktimi i dorës 14
5.10.2 Operimi i kohëmatësit të NDEZJES/FIKJES 14
5.10.3 Operimi i kohëmatësit javor 15
6 Kursimi i energjisë dhe operimi optimal 17
7 Mirëmbajtja dhe shërbimi 17
7.1 Pamje përgjithshme: Mirëmbajtja dhe shërbimi 17
7.2 Pastrimi i njësisë së brendshme dhe telekomandës uajrles 18
7.3 Pastrimi i panelit të përparmë 18
7.4 Si të hapni panelin e përparmë 18
7.5 Pastrimi i filtrave të ajrit 18
7.6 Pastrimi i filtrit aromatizues të apatitit prej titani dhe filtrit të grimcave të argjendta (filtri Ag-ion) 19
7.7 Ndërrimi i filtrit aromatizues të apatitit prej titani dhe filtrit të grimcave të argjendta (filtri Ag-ion) 19
7.8 Mbyllja e panelit të përparmë 19
7.9 Marrja parasysh e pikave të mëposhtme para një periudhe të gjatë 19
8 Zgjidhja 20
9 Hedhja 20


# 1 Rreth dokumentacionit

## 1.1 Rreth këtij dokumenti

Faleminderit që bletë produktin. Ju lutemi:

- Lexoni me kujdes dokumentacionin para përdorimit të ndërfaqes së përdoruesit për të garantuar performancën më të mirë të mundshme.
- Kërkojini instaluesit t'ju informojë për cilësimet që ka përdorur për të konfiguruar sistemin tuaj. Kontrolloni nëse i ka plotësuar tabelat e cilësimeve të instaluesit. Nëse JO, kërkojani përdoruesit ta bëjë.
- Ruajeni dokumentacionin për referencë në të ardhmen.

**Audienca e synuar**

Përdoruesit fundorë

**INFORMACION**

Qëllimi i kësaj pajisjeje është përdorimi nga përdoruesit ekspertë ose të trajnuar në dyqane, në industrinë e lehtë dhe ferma, ose për përdorim tregtar ose shtëpiak nga jo profesionistë.

**Seti i dokumentacionit**

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

- **Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë:**
  - Udhëzimet e sigurisë që duhet të lexoni para përdorimit të sistemit
  - Formati: Letër (te kutia e njësisë së brendshme)
- **Manuali i përdorimit:**
  - Udhëzues i shpejt për përdorimin bazë
  - Formati: Letër (te kutia e njësisë së brendshme)
- **Udhëzuesi referencë i instaluesit:**
  - Udhëzime të detajuara hap pas hapi dhe informacion për përdorimin bazë dhe atë të përparuar
  - Formati: skedarë digjitalë në https://www.daikin.eu. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.

Rishikimet më të fundit të dokumentacionit të siguruar mund të disponohen në faqen rajonale Daikin ose përmes instaluesit tuaj.

Dokumentacioni origjinal është i shkruar në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime.

# 2 Udhëzimet e sigurisë për përdoruesin

Zbatoni gjithmonë udhëzimet për sigurinë dhe rregullat vijuese.

## 2.1 Udhëzimet për përdorim të sigurt

**ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË**

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

**⚠ KUJDES**

Njësia e brendshme përmban pajisje radioje, distanca minimale e ndarjes mes pjesës së rrezatimit të pajisjes dhe përdoruesit është 10 cm.

**⚠ KUJDES**

MOS vini gishtat, shufra apo sende të tjera te pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit. Kur ventilatori rrotullohet me shpejtësi të lartë, shkaktohet lëndim fizik.

**⚠ PARALAJMËRIM**

- MOS modifikoni, çmontoni, hiqni, riinstaloni apo riparoni njësinë vetë, sepse çmontimi ose instalimi i pasaktë mund të shkaktojë tronditje elektrike ose zjarr. Kontaktoni distributorin tuaj.
- Në rast rrjedhjeje të rastësishme të ftohësit, sigurohuni që nuk ka flakë të hapura. Vetë ftohësi është krejtësisht i sigurt, jo toksik dhe lehtësisht i ndezshëm, por do të gjenerojë gaz toksik kur rrjedh aksidentalisht në një dhomë ku ka prani të ajrit të djegshëm nga ngrohës ventilatorësh, furnela gazi, etj. Gjithmonë kontaktoni personelin e kualifikuar të shërbimit të konfirmojë që pika e rrjedhjes është riparuar ose ndrequr para rifillimit të operimit.

**⚠ KUJDES**

GJITHMONË përdorni telekomandën uajrles ose ndërfaqe tjetër përdoruesi (nëse ka) për të rregulluar pozicionin e fllanxhave dhe frëngjive të ajrimit. Kur kapakët e xhepit dhe frëngjitë e ajrimit lëkunden dhe ju e lëvizni me dorë me forcë, mekanizmi prishet.

**⚠ KUJDES**

KURRË mos ekspozoni fëmijë të vegjël, bimë apo kafshë direkt me qarkullimin e ajrit.

**⚠ PARALAJMËRIM**

MOS vendosni shishe me spërkatës të djegshëm afër kondicionerit dhe MOS përdorni spërkatës afër njësisë. Kjo gjë mund të shkaktojë zjarr.

**⚠ KUJDES**

MOS e përdorni sistemin kur përdorni një insekticid të llojit të tymosjes së dhomës. Lëndët kimike mund të mblidhen te njësia dhe të rrezikojnë shëndetin e atyre që janë hiper të ndjeshëm ndaj lëndëve kimike.

**⚠ PARALAJMËRIM**

- Ftohësi brenda njësisë është pak i djegshëm, por normalisht NUK shkakton rrjedhje. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr ose formimin e një gazi të dëmshëm.
- FIKNI çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.
- MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.

**⚠ PARALAJMËRIM**

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.

**⚠ PARALAJMËRIM**

Pajisja duhet të ruhet për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa burime ndezjeje që janë vazhdimisht në gjendje pune (p.sh. flakë të hapura, pajisje gazi në gjendje pune ose një ngrohës elektrik po në gjendje pune).

Madhësia e dhomës duhet të jetë siç specifikohet në masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë.

**RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE**

Për të pastruar kondicionerin ose filtrin e ajrit, sigurohuni të ndalni operacionin dhe t'i fikni të gjitha furnizimet me energji. Përndryshe, kjo mund të shkaktojë shok elektrik dhe lëndim fizik.

**KUJDES**

Pas një përdorimi të gjatë, kontrollo mbështetësen e njësisë dhe montimin për dëmtime. Nëse dëmtohet, njësia mund të rrëzohet dhe çojë në dëmtim.

**KUJDES**

MOS i prekni krahët e shkëmbyesit të energjisë. Këto krahë janë të mprehtë dhe mund të çojnë në prerje.

**PARALAJMËRIM**

Bëni kujdes me shkallët kur punoni në vende të larta.

**PARALAJMËRIM**

Detergjentët e papërshtatshëm ose procedura e pastrimit mund të shkaktojë dëmtim të përbërësve plastikë ose rrjedhje të ujit. Detergjenti i spërkatur në përbërësit elektrikë, si motorë, mund të shkaktojë avari, tym ose ndezje.

**RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE**

Para pastrimit, sigurohuni të ndërprisni operimin, të fikni çelësin ose të tërhiqni kordonin e korrentit. Përndryshe, kjo mund të shkaktojë shok elektrik dhe lëndim fizik.

**PARALAJMËRIM**

**Ndalo operimin dhe fik energjinë, nëse ndodh diçka e pazakontë (erë djegieje, etj.).**

Lënia e njësisë në punë në këto rrethana mund të shkaktojë prishje, tronditje elektrike ose zjarr. Kontaktoni distributorin tuaj.

# 3 Rreth sistemit

**ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË**

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

**KUJDES**

Njësia e brendshme përmban pajisje radioje, distanca minimale e ndarjes mes pjesës së rrezatimit të pajisjes dhe përdoruesit është 10 cm.

**NJOFTIM**

MOS e përdorni sistemin për qëllime të tjera. Për të shmangur çdo përkeqësim të cilësisë, MOS e përdorni njësinë për mjetet e precizonit të ftohjes, ushqimin, bimët, kafshët ose veprat e artit.

## 3.1 Njësia e brendshme

**KUJDES**

MOS vini gishtat, shufra apo sende të tjera te pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit. Kur ventilatori rrotullohet me shpejtësi të lartë, shkaktohet lëndim fizik.

**INFORMACION**

Niveli i presionit të zërit është më pak se 70 dBA.

**PARALAJMËRIM**

- MOS modifikoni, çmontoni, hiqni, riinstaloni apo riparoni njësinë vetë, sepse çmontimi ose instalimi i pasaktë mund të shkaktojë tronditje elektrike ose zjarr. Kontaktoni distributorin tuaj.
- Në rast rrjedhjeje të rastësishme të ftohësit, sigurohuni që nuk ka flakë të hapura. Vetë ftohësi është krejtësisht i sigurt, jo toksik dhe lehtësisht i ndezshëm, por do të gjenerojë gaz toksik kur rrjedh aksidentalisht në një dhomë ku ka prani të ajrit të djegshëm nga ngrohës ventilatorësh, furnela gazi, etj. Gjithmonë kontaktoni personelin e kualifikuar të shërbimit të konfirmojë që pika e rrjedhjes është riparuar ose ndrequr para rifillimit të operimit.

**Butoni ON/OFF**

Nëse ndërfaqja e përdoruesit (p.sh. telekomanda uajrles) mungon, mund të përdorni butonin e NDEZJES/FIKJES te njësia e brendshme për të filluar/ndalur përdorimin. Kur përdormi fillon duke përdorur këtë buton, përdoren këto cilësime:

- Gjendja e operimit = Automatik
- Cilësimi i temperaturës = 25°C
- Shkalla e qarkullimit të ajrit = Automatik

### 3.1.1 Llamba e treguesit të syrit Daikin

Ngjyra e syrit Daikin do të ndryshojë sipas operimit.




**a** Butoni i ON/OFF
**b** Daikin eye (me marrësin e sinjalit infrakuq)

| Përdorimi | Ngjyra e syrit Daikin |
|---|---|
| Automatik | E kuqe/blu |
| Ftohja | Blu |
| Ngrohja | E kuqe |
| Vetëm me ventilator | E bardhë |
| Tharja | Jeshil |
| Operimi i kohëmatësit | Portokalli[a] |

[a] Kur është vendosur kohëmatësi i NDEZJES/FIKJES ose kohëmatësi Javor, syri Daikin ndryshon herë pas here në portokalli. Pas ndriçimit me portokalli për rreth 10 sekonda, kthehet në ngjyrën e modalitetit të operimit për 3 minuta.
**Shembull:** Kur kohëmatësi është i vendosur gjatë operimit të ftohjes, syri Daikin do të ndriçojë herë pas here ngjyrën portokalli për 10 sekonda, dhe pastaj kalon në ngjyrën blu për 3 minuta.

## 3.2 Rreth ndërfaqes së përdoruesit

**Telekomanda uajrles**

**INFORMACION**

Njësia e brendshme dorëzohet me telekomandën uajrles si ndërfaqja e përdoruesit. Ky manual përshkruan vetëm operimin me këtë ndërfaqe përdoruesi. Nëse lidhet një ndërfaqe tjetër përdoruesi, referojuni manualit të operimit të ndërfaqes së lidhur të përdoruesit.

- **Drita e drejtpërdrejtë e diellit.** MOS e ekspozoni telekomandën uajrles ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit.
- **Pluhuri.** Pluhuri në transmetuesin ose marrësin e sinjalit do të reduktojë ndjeshmërinë. Pastroni pluhurin me një leckë të butë.
- **Dritat fluoreshente.** Komunikimi i sinjalit mund të çaktivizohet nëse në dhomë ka llamba fluoreshente. Nëse është kështu, kontaktoni me instaluesin tuaj.
- **Pajisjet e tjera.** Nëse sinjalet e telekomandës operojnë pajisjet e tjera, lëvizni pajisjet e tjera ose kontaktoni me instaluesin tuaj.
- **Perdet.** Sigurohuni që perdet ose sendet e tjera NUK e bllokojnë sinjalin mes njësisë dhe telekomandës uajrles.

**NJOFTIM**

- MOS e rrëzoni telekomandën uajrles.
- MOS e lini telekomandën uajrles të laget.

### 3.2.1 Përbërësit: Telekomanda uajrles




**a** monitor LCD
**b** Butonat e temperaturës lart/poshtë dhe navigimi në meny lart/poshtë
**c** Butoni ON/OFF
**d** Butoni i operimit të fuqishëm
**e** Butonat majtas/djathtas të navigimit në meny
**f** Butoni i konfirmimit
**g** Butoni i menysë kryesore
**h** Operimi në heshtje e njësisë së jashtme
**i** Butoni i përzgjedhjes së modalitetit (automatik, ftohje, ngrohje, tharje, vetëm ventilator)
**j** Butoni i cilësimit të shkallës së qarkullimit të ajrit

### 3.2.2 Operimi i telekomandës uajrles




**a** Marrësi i sinjalit infrakuq

**Shënim:** Sigurohuni që të mos ketë pengesa brenda 500 mm poshtë marrësit të sinjalit infrakuq. Ato mund të ndikojnë në performancën e marrjes të telekomandës.

1. Drejtoni transmetuesin e sinjalit nga marrësi i sinjalit infrakuq te njësia e brendshme (distanca maksimale për komunikim është 7 m).

**Rezultati:** Kur njësia e brendshme merr një sinjal nga telekomanda uajrles, do të dëgjoni një tingull:

| Tingulli | Përshkrimi |
|---|---|
| Bip-bip | Fillon operimi. |
| Bip | Cilësimi ndryshon. |
| Bip i gjatë | Ndalon operimi. |

# 4 Para përdorimit

**INFORMACION**

Ky manual përmban vetëm disa cilësime para operimit.

Referojuni **udhëzuesit referencë të përdoruesit** që gjendet në https://qr.daikin.eu/?N=FTXJ-AW nën "Dokumentacioni" për më shumë cilësime para përdorimit.

- **Cilësimi i njësisë së brendshme:** ndriçimi i Daikin Eye, hapni panelin e përparmë, lidhja uajrles LAN, funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit, pozicioni i instalimit të njësisë së brendshme, mbani funksionin e tharjes
- **Cilësimi i telekomandës uajrles:** Kontrasti LCD, ndriçimi LCD, koha e fikjes së LCD, dërgim automatik pas zgjedhjes, kanalet e marrësit infra të kuq të njësisë së brendshme

## 4.1 Vendosja e baterive

Bateritë do të zgjasin rreth 1 vit.

1 Hiqni kapakun prapa.

2 Vërini bateritë njëkohësisht.

3 Vendosni sërish kapakun.




**INFORMACION**

- Energjia e ulët e baterisë tregon vezullimin e [ikonë] në ekranin LCD (pozicioni i parë).
- Kur bateritë janë në nivel të ulët, funksionet e telekomandës uajrles pezullohen dhe vetëm mund të FIKNI operimin, të gjitha funksionet e kohëmatësit janë FIKUR. Ndërroni bateritë sa më shpejt të jetë e mundur.
- GJITHMONË ndërroni të dy bateritë së bashku.

## 4.2 Montimi i mbajtëses magnetike të telekomandës uajrles




**a** Telekomanda uajrles
**b** Vidhat (siguruar nga klienti)
**c** Mbajtësja magnetike e telekomandës uajrles

1 Zgjidhni një vend ku sinjalet kapin njësinë.

2 Ngjitni mbajtësen me vidha në mur ose një vend të ngjashëm.

3 Varni telekomandën uajrles në mbajtëse.

**INFORMACION**

Mbajtësja e telekomandës uajrles është magnetike. Sigurohuni të vendosni mbajtësen me anën e djathtas për sipër.

## 4.3 Ndezja e furnizimit me energji

1 Ndizni çelësin e dritës.

**Rezultati:** Kapaku i xhepit të njësisë së brendshme do të hapet dhe mbyllet për të caktuar pozicionin e referencës.

## 4.4 Cilësimi i njësisë së brendshme

1 Hyni në menynë kryesore duke shtypur ⋯ dhe navigoni për te njësia e cilësimit të njësisë së brendshme duke përdorur ‹ dhe ›. Shtypni ✓ për të hyrë në meny.

**Menyja e cilësimit të njësisë së brendshme**



2 Kryeni cilësimet e renditura më poshtë.

3 Shtypni ✓ për t'u kthyer te menyja kryesore ose shtypni ⋯ për të dalë nga ekrani kryesor.

### 4.4.1 Hapni panelin e përparmë

Paneli i përparmë hapet automatikisht kur fillon operimi. Kur doni të hapni panelin e përparmë kur operimi është te FIKUR, përdorni këtë veçori. **Shembull:** gjatë mirëmbajtjes.

#### Hapja e panelit të përparmë duke përdorur telekomandën uajrles

1 Sigurohuni që operimi është FIKUR. Nëse jo, shtypni FIKUR duke përdorur ⏻.

2 Në menynë e cilësimit të njësisë së brendshme, navigoni për të hapur ekranin e panelit duke përdorur ‹ dhe ›.

**Hapni ekranin e panelit të përparmë**




3 Shtypni për ta konfirmuar.

**Rezultati:** Hapet paneli i përparmë.

4 Shtypni sërish për të mbyllur panelin e përparmë ose shtypni për t'u kthyer tek ekrani kryesor.

## 4.4.2 Lidhje uajrles LAN

Thjesht lidhni njësinë me rrjetin e shtëpisë dhe shkarkoni aplikacionin për të ndërruar termostatin, caktoni oraret e temperaturës, kontrolloni konsumin e energjisë dhe shumë të tjera.

Për detaje mbi specifikimet, cilësimin e metodave, Pyetjet e Shpeshta FAQ, udhëzimet e zgjidhjes së problemeve, vizitoni app.daikineurope.com.

Klienti mban përgjegjësi për të ofruar:

- Telefon inteligjent ose tablet me versionin minimal të mbështetur të Android ose iOS, përcaktuar në app.daikineurope.com.
- Linjë interneti dhe pajisje komunikimi si modem, ruter etj.
- Pikë aksesi linje LAN uajrles
- Aplikacioni ONECTA i instaluar falas

**Shënim:** Nëse nevojitet, SSID (Identifikuesi i Grupit të Shërbimit) dhe KEY (fjalëkalimi) gjenden në njësi.




**a** Etiketë me SSID dhe KEY

### Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë

MOS e përdorni afër:

- **Pajisjeve mjekësore.** P.sh. personave që përdorin stimulues kardiakë ose defibrilatorë. Ky produkt mund të shkaktojë interferencë elektromagnetike.
- **Pajisjeve me kontroll automatik.** P.sh. dyerve automatike ose pajisjeve të alarmit të zjarrit. Ky produkt mund të shkaktojë defekte të pajisjes.
- **Mikrovalës.** Mund të ndikojë te komunikimet uajrles LAN.

### Instalimi i aplikacionit ONECTA

1 Hapni:
   - Google Play për aparaturat që përdorin Android.
   - App Store për aparaturat që përdorin iOS.

2 Kërkoni për "ONECTA".

3 Ndiqni udhëzimet në ekran për instalim.

**Kërkoni direkt aplikacionin duke përdorur QR në ekranin e telekomandës uajrles**

1 Hyni në menynë kryesore duke shtypur dhe navigoni për te menyja e cilësimit të telekomandës uajrles duke përdorur dhe .

2 Shtypni për të hyrë në meny.

**Menyja e cilësimit të kontrollit të telekomandës**



3 Navigoni për tek ekrani i kodit të QR duke përdorur dhe .

4 Skanoni kodin QR me telefonin tuaj inteligjent ose pajisjet e tjera inteligjente.

**Rezultati:** Kodi QR do t'ju ridrejtojë te App Store ose Google Play.




5 Ndiqni udhëzimet në ekran për instalim.

**INFORMACION**

Nëse kodi QR është i vështirë për t'u lexuar, ndërroni kodin QR duke përdorur ose , pastaj provoni sërish.

### Caktimi i lidhjes uajrles

Ka dy opsione për të lidhur përshtatësin uajrles me rrjetin tuaj të shtëpisë.

- Duke përdorur një pajisje inteligjente (telefon inteligjent, tablet) dhe SSID (Identifikuesi i Grupit të Shërbimit) dhe KEY (fjalëkalimi)
- Duke përdorur butonin WPS (konfigurim i mbrojtur nga Wi-fi) në ruterin tuaj Wi-Fi.

Për më shumë informacion dhe Pyetje të Shpeshta (FAQ) , referojuni app.daikineurope.com.

**Shënim:** Cilësimi bëhet me anën e telekomandës në menynë e cilësimit të LAN-it me valë. Gjatë cilësimit, gjithmonë drejtoni telekomandën uajrles nga marrësi i sinjalit infrakuq në njësi.

**INFORMACION**

Sigurohuni që të ndalojë operimi para se të cilësoni lidhjen uajrles. Lidhja NUK MUND të kryhet kur njësia është në operim.

1 **Ndalni përdorimin** para cilësimit të lidhjes me valë.

2 Sigurohuni që ruteri uajrles është afër me njësinë dhe asgjë nuk e pengon sinjalin.

| Meny | Përshkrimi |
|---|---|
|  | ▪ ON = LAN-i me valë është NDEZUR (cilësimi i lidhjes së modalitetit AP/modalitetit EKZEKUTO (SSID + KEY)) ▪ OFF = LAN-i me valë është FIKUR |

| Meny | Përshkrimi |
|---|---|
|  | Dilni nga menyja e cilësimit |
|  | Cilësimi i lidhjes WPS |
|  | Rivendos në Parazgjedhjen e caktuar nga fabrika |
|  | Kontrolli i statusit të lidhjes |

### Lidhja e LAN-it me valë me rrjetin tuaj të shtëpisë

Përshtatësi uajrles mund të lidhet me me rrjetin tuaj të shtëpisë duke përdorur:

- Butonin WPS (konfigurim i mbrojtur me Wi-Fi) në ruter (nëse ka),
- SSID (Identifikuesi i Grupit të Shërbimit) dhe the KEY (fjalëkalimi) - që gjenden në njësi.

1 Në menynë e cilësimit të njësisë së brendshme, navigoni për te lidhja LAN me valë duke përdorur ‹ dhe ›. Shtypni ✓ për të hyrë në meny.

| Menyja e cilësimit të njësisë së brendshme | Cilësimi i lidhjes LAN me valë |
|---|---|
|  |  |

2 Ndryshoni cilësimin në ON duke përdorur ˄ dhe ˅. Shtypni ✓ për të konfirmuar zgjedhjen.

| Sinjali i LAN-it me valë është NDEZUR | Sinjali i LAN-it me valë është FIKUR |
|---|---|
|  |  |

**Rezultati:** Teknika e lidhjes shfaqet në ekran për 5 sekonda dhe tregohet ekrani i statusit të LAN-it me valë.

3 Vazhdoni cilësimin duke përdorur butonin WPS ose SSID dhe KEY.

### Lidhja duke përdorur butonin WPS

1 Navigoni për tek ekrani WPS me ‹ dhe ›. Shtypni ✓ për të konfirmuar zgjedhjen.

**Rezultati:** Ngjyra e Daikin Eye ndryshon mes portokallisë dhe pjesërisht jeshiles.

**Cilësimi i WPS**




2 Shtypni butonin WPS te pajisja juaj e komunikimit (p.sh. ruter) brenda rreth 1 minute. Referojuni manualit të pajisjes suaj të komunikimit.

**Rezultati:** Nëse lidhja ishte e suksesshme, ngjyra e Daikin Eye alternohet mes blusë dhe jeshiles së pjesshme.

> **INFORMACION**
>
> Nëse lidhja me ruterin nuk është e mundur, provo procedurën "Lidhja duke përdorur SSID dhe numrin e ÇELËSIT" [▸ 8].

3 Shtypni ⋯ për të dalë nga ekrani kryesor ose përdorni ekranin DALJE për t'u kthyer te "menyja e cilësimit të njësisë së brendshme".

### Lidhja duke përdorur SSID dhe numrin e ÇELËSIT

1 Hapni aplikacion ONECTA në pajisjen tuaj inteligjente dhe ndiqni hapat në ekran.

2 Lidhni pajisjen tuaj inteligjente me të njëjtin rrjet shtëpie si njësia.

3 Kontrolloni nëse lidhja ishte e sukses (referojuni "Konfirmimi i statusit të lidhjes së LAN-it me valë" [▸ 8]).

4 Shtypni ⋯ për të dalë nga ekrani kryesor ose përdorni ekranin DALJE për t'u kthyer te "menyja e cilësimit të njësisë së brendshme".

### Konfirmimi i statusit të lidhjes së LAN-it me valë

1 Navigoni për tek ekrani i statusit duke përdorur ‹ dhe ›. Shtypni ✓ për ta konfirmuar.

**Ekrani i statusit**




2 Kontrolloni Daikin Eye.




- **a** Syri Daikin
- **b** Pjesërisht jeshile
- **c** E kuqe, portokalli ose blu

| Ngjyra e Daikin Eye ndryshon nga pjesërisht jeshile dhe… | …pastaj përshtatësi uajrles është… |
|---|---|
| **E kuqe** | nuk është i lidhur |
| **portokalli** | po punon dhe është gati të lidhet me rrjetin e shtëpisë përmes butonit WPS në ruter; shikoni "Lidhja duke përdorur butonin WPS" [▸ 8]. |
| **blu** | u lidh me rrjetin e shtëpisë:<br>▪ përmes SSID + KEY.<br>ose<br>▪ përmes butonit WPS në ruter. |

3 Shtypni ⋯ për të dalë nga ekrani kryesor ose përdorni ekranin DALJE për t'u kthyer te menyja e cilësimit të njësisë së brendshme.

#### Kthimi i cilësimit të lidhjes në parazgjedhjen e fabrikës

Rivendosni cilësimin e lidhjes në parazgjedhjen e fabrikës në rast se doni të:

- shkëputni LAN-in me valë dhe pajisjen e komunikimit (p.sh. ruterin) ose pajisjen inteligjente.
- përsëritni cilësimin nëse lidhja ishte e pasuksesshme.

1 Navigoni për tek ekrani RIVENDOS duke përdorur dhe . Shtypni për të konfirmuar zgjedhjen.

**Rezultati:** Cilësimi është rivendosur në parazgjedhjen e fabrikës.

**Ekrani i rivendosjes**




2 Shtypni për të dalë nga ekrani kryesor ose përdorni ekranin DALJE për t'u kthyer te menyja e cilësimit të njësisë së brendshme.

#### Fikja e lidhjes së LAN-it me valë

1 Hyni në menynë e cilësimit të lidhjes LAN me valë dhe ndryshoni cilësimin në OFF duke përdorur dhe . Shtypni për të konfirmuar zgjedhjen.

**Rezultati:** Daikin Eye ndryshon mes jeshiles dhe të bardhës. Komunikimi është i FIKUR.

### 4.4.3 Funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit

Ky funksion ndihmon me qarkullimin optimal të ajrit dhe shpërndarjen e temperaturës në modalitetin e operimit të ngrohjes. Këtë funksion mund ta FIKNI në rast se ka mobile ose një tjetër objekt poshtë njësisë.

**Qarkullimi vertikal i ajrit FIKUR**



**Qarkullimi vertikal i ajrit NDEZUR**



### NDEZJA/FIKJA e funksionit të qarkullimit vertikal të ajrit

1 Në menynë e cilësimit të njësisë së brendshme, navigoni për te cilësimi i qarkullimi vertikal të ajrit duke përdorur dhe .

**Funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit NDEZUR**




**Funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit FIKUR**




2 Ndryshoni cilësimin duke përdorur dhe .

3 Shtypni për të konfirmuar zgjedhjen.

4 Shtypni sërish për t'u kthyer te menyja kryesore ose shtypni për t'u kthyer tek ekrani kryesor.

# 5 Përdorimi

**INFORMACION**

Njësia e brendshme dorëzohet me telekomandën uajrles si ndërfaqja e përdoruesit. Ky manual përshkruan vetëm operimin me këtë ndërfaqe përdoruesi. Nëse lidhet një ndërfaqe tjetër përdoruesi, referojuni manualit të operimit të ndërfaqes së lidhur të përdoruesit.

## 5.1 Gama e operimit

Përdore sistemin në kufijtë vijues të temperaturës dhe lagështisë për përdorim të sigurt dhe të efektshëm.

| | Ftohje dhe tharje[(a)(b)] | Ngrohja[(a)] |
|---|---|---|
| Temperatura jashtë për modelet RXJ | –10~50°C DB | –20~24°C DB<br>–21~18°C WB |
| Temperatura jashtë për modelet 2MXM, 3MXM, 4MXM, 5MXM | –10~46°C DB | –15~24°C DB<br>–15~18°C WB |
| Temperatura brenda | 18~37°C DB<br>14~28°C WB | 10~30°C DB |
| Lagështia e brendshme | ≤80%[(a)] | — |

(a) Një pajisje sigurie mund ta ndalojë operimin e sistemit nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.
(b) Kondensimi dhe pikimi i ujit mund të ndodhë nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.

## 5.2 Gjendja e operimit dhe vlera e dëshiruar e temperaturës

**Kur.** Rregulloni gjendjen e operimit të sistemit dhe caktoni temperaturën kur doni të:

- Ngrohni ose ftohni dhomën
- Lëshoni ajër në dhomë pa ngrohje ose ftohje
- Ulni lagështinë në dhomë

**Çfarë.** Sistemi operon ndryshe në varësi të zgjedhjes së përdoruesit.

| Cilësimi | Përshkrimi |
|---|---|
| Automatik<br> | Sistemi ftoh ose ngroh dhomën në vlerën e dëshiruar të temperaturës. Kalon automatikisht nga ftohja në ngrohje nëse është e nevojshme. |
| Ftohja<br> | Sistemi ftoh dhomën në vlerën e dëshiruar të temperaturës. |
| Ngrohja<br> | Sistemi ngroh dhomën në vlerën e dëshiruar të temperaturës.<br>**Përforcimi i ngrohjes**<br>Kjo veçori është automatike; ngroh shpejt shtëpinë tuaj kur ndizni pajisjen në modalitetin e ngrohjes. |
| Vetëm me ventilator<br> | Sistemi kontrollon vetëm qarkullimin e ajrit (shkalla e qarkullimit të ajrit dhe drejtimi i qarkullimit të ajrit).<br>Gjatë këtij operimi NUK MUND të caktoni temperaturën. |
| Tharja<br> | Sistemi ul lagështinë në dhomë.<br>Gjatë këtij operimi NUK MUND të caktoni temperaturën. |

**Informacion shtesë:**

- **Temperatura jashtë.** Efekti ftohës ose ngrohës i sistemit ulet kur temperatura jashtë është shumë e lartë ose shumë e ulët.
- **Operimi i heqjes së ngricës.** Gjatë operimit të ngrohjes, mund të krijohet ngricë te njësia e jashtme dhe ulet kapaciteti i ngrohjes. Në atë rast, sistemi kalon automatikisht nga operimi i heqjes së heqjes së ngricës në heqjen e plotë të saj. Gjatë operimit të heqjes së ngricës, NUK lëshohet ajër i ngrohtë nga njësia e brendshme.
- **Sensori i lagështisë.** Kontrolloni lagështinë duke e ulur atë gjatë procesit të ftohjes.

### 5.2.1 Fillimi/ndalja e modalitetit të operimit dhe caktimi i temperaturës

**Modaliteti i operimit**

1 Shtypni për të hyrë në menynë karusel të modalitetin të operimit. Kur shtypet pa ndërprerje, modaliteti do të ndryshojë si më poshtë:



**INFORMACION**

- Në menynë e karuselit, mund të navigoni në të dy drejtimet duke përdorur dhe ose dhe .
- Menyja e karuselit do të fillojë gjithmonë me cilësimin aktualisht aktiv.

2 Shtypni për **të filluar** përdorimin.

3 Ekrani kryesor ndryshon si më poshtë dhe llambat e treguesit të Daikin Eye vazhdon të jetë e NDEZUR.

| Ekrani kryesor kur njësia është e NDEZUR gjatë… | | |
|---|---|---|
| ngrohjes, ftohjes, operimit automatik | operimi i tharjes | operim vetëm me ventilator |
|  |  |  |

**Pika e kontrollit të temperaturës**

4 Shtypni ose një ose disa herë për të ulur ose **vlerë e dëshiruar të temperaturës**.

| Operimi i ftohjes | Përdorimi i ngrohjes | Përdorimi automatik | Tharja ose përdorimi vetëm me ventilator |
|---|---|---|---|
| 18~32°C | 10~30°C | 18~30°C | Nuk ka vlerë të dëshiruar[a] |

[a] Kur përdorni **tharjen** ose gjendjen **vetëm me ventilator**, NUK MUND ta rregulloni temperaturën.

5 Shtypni për **të ndaluar** përdorimin.

**Rezultati:** Ekrani kryesor ndryshon si më poshtë dhe llambat e treguesit të Daikin Eye vazhdon të jetë e FIKUR.

**Ekrani kryesor kur njësia është e FIKUR**



## 5.3 Shkalla e qarkullimit të ajrit

**INFORMACION**

- Kur përdorni operimin e tharjes, NUK MUND ta rregulloni cilësimin e shkallës së qarkullimit të ajrit.
- Shkalla e qarkullimit të ajrit në modalitetin e ngrohjes do të ulet për të shmangur gjenerimin e qarkullimit të ajrit të ftohtë. Kur temperatura e qarkullimit të ajrit rritet, operimi do të vazhdojë me shkallën e caktuar të qarkullimit të ajrit.

Mund të rregulloni fuqinë e qarkullimit të ajrit që del nga njësia e brendshme.

| Cilësimi | Përshkrimi |
|---|---|
| Shpejtësi e ventilatorit 1~5  | 5 nivele të shkallës së qarkullimit të ajrit nga i ulëti në të lartin. |
| Automatik  | Njësia e brendshme e rregullon automatikisht shpejtësinë e ventilatorit sipas vlerës së dëshiruar dhe temperaturës së brendshme. |
| Operimi në qetësi e njësisë së brendshme  | Për pakësimin e zhurmës që vjen nga njësia e brendshme<br>(**Shembull:** natën) |

**INFORMACION**

Nëse njësia arrin temperaturën e dëshiruar:

- në modalitetin e ftohjes ose automatik. Ventilatori ndalon së operuari.
- në modalitetin e ngrohjes. Ventilatori do të operojë në shkallë të ulët qarkullimi të ajrit.

### 5.3.1 Rregullimi i shkallës së qarkullimit të ajrit

1 Shtypni për të hyrë në menynë karusel të shkallës së qarkullimit të ajrit. Kur shtypet pa ndërprerje, modaliteti do të ndryshojë si më poshtë:



**INFORMACION**

- Në menynë e karuselit, mund të navigoni në të dy drejtimet duke përdorur dhe ose dhe .
- Menyja e karuselit do të fillojë gjithmonë me cilësimin aktualisht aktiv.

## 5.4 Drejtimi i qarkullimit të ajrit

Drejtimi i qarkullimit të ajrit është drejtimi nga i cili lëshon ajrin njësia e brendshme. Këtë e mundëson duke lëvizur tehet horizontale (kapakët e xhepit) ose vertikale (frëngji ajrimi). Përshtatni drejtimin e qarkullimit të ajrit sipas dëshirës dhe në pozicionin e lëkundur ose të fiksuar.

| Cilësimi | Drejtimi i qarkullimit të ajrit |
|---|---|
| Lëkundja automatike vertikale  | Lëviz lart e poshtë helikat horizontale (fllanxhat). |

| Cilësimi | Drejtimi i qarkullimit të ajrit |
|---|---|
| Lëkundja automatike horizontale  | Lëviz helikat vertikale (frëngjitë) nga njëra anë në tjetrën. |
| Drejtimi i qarkullimit të ajrit 3-D  | Lëviz në mënyrë të alternuar poshtë e lart dhe nga njëra anë në tjetrën |
| [—] | Qëndron në një pozicion të fiksuar. |

**KUJDES**

GJITHMONË përdorni telekomandën uajrles ose ndërfaqe tjetër përdoruesi (nëse ka) për të rregulluar pozicionin e fllanxhave dhe frëngjive të ajrimit. Kur kapakët e xhepit dhe frëngjitë e ajrimit lëkunden dhe ju e lëvizni me dorë me forcë, mekanizmi prishet.

Gama e lëvizjes së kapakut të xhepit ndryshon sipas gjendjes së operimit. Kapaku i xhepit do të ndalojë te pozicioni i sipërm kur shkalla e qarkullimit të ajrit ndryshon në të ultë gjatë cilësimit të lëkundjes poshtë e lart.

### Qarkullimi i ajrit në gjendje qetësie

Njësia do të ndryshojë automatikisht drejtimin e qarkullimit të ajrit për ta ngrohur ose ftohur më me efekt dhomën. Qarkullimi i drejtpërdrejtë i ajrit nga njësia do të vihet re më pak.




- **a** Pozicioni i kapakut të xhepit dhe përdorimi i tharjes
- **b** Pozicioni i kapakut të xhepit në operimin e ngrohjes (**qarkullimi vertikal i ajrit FIKUR**)
- **c** Pozicioni i fllanxhës në operimin e ngrohjes (**qarkullimi vertikal i ajrit NDEZUR**)

### Në ftohje dhe tharje



Drejtimi i qarkullimit të ajrit do të ndryshojë për të përhapur ajrin përgjatë gjithë dyshemesë.

| Qarkullimi i ajrit në gjendje komode **aktiv** | Qarkullimi i ajrit në gjendje komode **jo aktiv** |
|---|---|
|  |  |

### Në ngrohje



Drejtimi i qarkullimit të ajrit do të rregullohet për të përhapur ajrin përgjatë gjithë tavanit.

**Nëse funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit është NDEZUR**: Njësia dikton temperaturën e dhomës dhe të dyshemesë dhe automatikisht zgjedh 1 nga 3 drejtime të ajrit (ngrohjen e hapësirës, tatëpjetë, vertikal).

**Nëse funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit është FIKUR:** Njësia do të operojë vetëm në drejtimin e qarkullimit tatëpjetë të ajrit.

| Qarkullimi i ajrit të ngrohjes së hapësirës | Qarkullimi tatëpjetë i ajrit | Qarkullimi vertikal i ajrit |
|---|---|---|
|  |  |  |

**INFORMACION**

Nëse doni të çaktivizoni funksionin e qarkullimit vertikal të ajrit (p.sh. në rast se ka mobilie ose sende të tjera poshtë njësisë) referojuni "NDEZJA/FIKJA e funksionit të qarkullimit vertikal të ajrit" [▸ 9]. Nëse funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit çaktivizohet qarkullimi i ajrit kalon në drejtimin tatëpjetë.

**INFORMACION**

Operimi i fuqishëm dhe i qarkullimit të ajrit në gjendje qetësie NUK MUND të përdoret në të njëjtën kohë. Përparësi merr funksioni i zgjedhur në fund. Nëse zgjidhet lëkundja vertikale automatike, operimi i qarkullimit të ajrit në gjendje qetësie do të anulohet.

1. Hyni në menynë kryesore duke shtypur ⋯ dhe navigoni për te menyja e cilësimit të drejtimit të qarkullimit të ajrit duke përdorur ‹ dhe ›. Shtypni ✓ për të hyrë në meny.

   **Menyja e cilësimit të drejtimit të qarkullimit të ajrit**

   

2. Në këtë meny, kryeni cilësimet e mëposhtme të qarkullimit të ajrit. Atëherë shtypni ✓ për t'u kthyer te menyja kryesore ose shtypni ⋯ për të dalë nga ekrani kryesor.

## 5.4.1 Rregullimi i drejtimit të qarkullimit vertikal të ajrit

1. Në menynë e cilësimit të drejtimit të qarkullimit të ajrit, navigoni për te cilësimi i qarkullimit vertikal të ajrit duke përdorur ‹ dhe ›.
2. Ndryshoni cilësimin duke përdorur ^ dhe ˅.

| Qarkullimi vertikal i ajrit - lëkundje | Qarkullimi vertikal i ajrit - i fiksuar |
|---|---|
|  |  |

3. **Për lëkundje vertikale.** Shtypni ✓ për të konfirmuar zgjedhjen.

   **Rezultati:** shfaqet në fund të ekranit kryesor. Kapakët e xhepit (tehet horizontalë) do të fillojnë të lëkunden.

4. **Për pozicionin e fiksuar.** Shtypni ✓ kur fllanxhat arrijnë pozicionin e dëshiruar.

